

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

**27.04.2023
Ora 12:09**

RENDI I DITËS

Cështje jashtë rendit të ditës

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj**
- **Parti politike:** **PL (A. Kaziaj) PD (I. Sefa)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite projektvendimin që lidhet me shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga operatorët e shërbimeve të transmetimit audioviziv për periudhën 14 prill-22 prill 2023; kemi projektvendimin që lidhet me shqyrtimin e kërkesave për akreditimin e disa medieve dhe pastaj kemi shqyrtimin e disa denoncimeve nga organizata KRIIK, denoncimet nr. 172, nr. 173, nr. 174, nr.175 lidhur me Bashkinë Cërrrik; denoncimin nr. 180 lidhur me Bashkinë Poliçan; denoncimet nr. 182, nr. 183 lidhur me Bashkinë Kamëz; denoncimin nr. 213 lidhur me Bashkinë Devoll; denoncimin nr. 214 lidhur me Bashkinë Fier; denoncimin nr. 215 lidhur me Bashkinë Krujë; denoncimin nr. 218 lidhur me Bashkinë Lezhë; denoncimin nr. 219 lidhur me Bashkinë Elbasan; denoncimin nr. 233 ndaj Agjencisë Shtetërore të Pyjeve; kemi denoncimin nr. 222 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit ndaj Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Korçë; kemi shqyrtimin e denoncimeve nr. 222 dhe nr. 227 të sinjalizuesve ndaj Bashkisë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Tropojë; kemi shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 228 të deputetes Albana Vokshi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Korçë; kemi shqyrtimin e denoncimit të Partisë Socialiste ndaj subjektit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, denoncimi nr. 387. Këto çështje janë në rendin e ditës. Përfaqësuesit e partive politike, keni diçka në lidhje me rendin e ditës? Po, përfaqësuesi i Partisë së Lirisë dhe i koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Komisioner! Në lidhje me rendin e ditës, unë do të doja që për procedurë të merrja fjalën për disa shqetësime të karakterit ligjor që kemi si koalicion, nëse mundem. Janë jashtë rendit të ditës këto. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord. Nëse nuk kemi ndonjë çështje që meriton shqyrtim në këtë seancë...

Z. A. Kaziaj: Janë çështje shumë sensitive dhe çështje të karakterit ligjor, të cilat meritojnë jo vetëm shqyrtim, por edhe vëmendje nga ana juaj si përfaqësuesi më i lartë i këtij institucioni.

Z. I. Celibashi: Dakord.

Z. A. Kaziaj: Ju bëj me dije që dje nga ana jonë është depozituar nëpërmjet protokollit në institucionin tuaj një shkresë që kërkon marrjen e masave të menjëhershme nga ana juaj. Ka të bëjë me një denoncim lidhur me emërimin e një anëtari të ZAZ-së, flasim për ZAZ-në nr. 39, i cili është në një masë disiplinore, kjo në kundërshtim me nenin 31, shkronja “d”, ku parashikohet që nuk mund të emërohet një anëtar ZAZ-je në momentin që ndaj tij në proces zgjedhor është marrë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

një masë disiplinore. Nuk e di se çfarë ka bërë institucioni që ju përfaqësoni në këtë moment nga dita e djeshme deri sot. A është marrë ndonjë vendimmarrje? Do të doja të kisha informacion në lidhje me këtë çështje, duke qenë se është emëruar në kundërshtim me ligjin. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: E keni verifikuar?

Z. Y. Merkaj: Po, e kemi bërë verifikimin. Kërkesa që ka bërë përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë” qëndron. Personi i propozuar nga Partia Demokratike është me masë disiplinore. I kemi bërë kërkesë subjektit ta zëvendësojë dhe jemi në pritje të zëvendësimit.

Z. I. Celibashi: Nëse nga verifikimi rezulton që anëtari i KZAZ-së është me masë disiplinore, do të duhet të shkarkohet. Çështja e zëvendësimit është çështje tjetër, kështu që duhet marrë vendimi për shkarkimin.

Z. Y. Merkaj: Nga verifikimi rezulton i tillë.

Z. I. Celibashi: Nëse rezulton kështu, duhet të merret vendimi për shkarkim, kështu që e konsiderojmë të mbyllur këtë çështje.

Z. I. Sefa: Mundem?

Z. I. Celibashi: Po.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Sefa: Besoj që ka të bëjë me subjektin që unë përfaqësoj. Në dijeninë time, kam marrë të gjithë anëtarët e KZAZ-së në periudhën që kanë qenë, sa për informacion, ky qenka edhe shqetësim themelor në funksion të zgjedhjeve, do të kërkoj nga administrata të më vërë në dispozicion të gjitha masat disiplinore për anëtarët e KZAZ-vë në të gjithë Shqipërinë, që t'i verifikojmë edhe ne.

Z. I. Celibashi: Po, e drejtë. Të gjithë informacionin që kemi në lidhje me masat disiplinore të marra ndaj anëtarëve të KZAZ-ve në zgjedhjet e shkuara t'u vihen në dispozicion partive politike që kanë të drejtën për të propozuar, por edhe çdo subjekti tjetër zgjedhor për të bërë verifikimet. Dakord?

Z. Y. Merkaaj: Dakord. Në fund të mbledhjes unë i kam gati.

Z. I. Celibashi: Dakord.

Z. A. Kaziq: Kisha edhe çështjen e dytë. Faleminderit! Zoti Komisioner, faleminderit që keni marrë masa të menjëhershme për shkarkimin e personit që është emëruar në kundërshtim me ligjin dhe ju ftojme e ju nxisim që këto masa t'i merrni ndaj të gjithë personave që kanë ndalesa ligjore dhe janë emëruar në kundërshtim me ligjin, me një papërgjegjshmëri dhe qëllimshmëri totale të personave që merren me emërimin e tyre. Për sa i përket shqetësimit të dytë, do të doja t'ju vija në dijeni ju si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, por edhe administratën e KQZ-së se po ndodh një paligjshmëri shumë e madhe për sa i përket pjesës së shtyrjes së afatit për emërimin e anëtarëve të QV-së. Kjo paligjshmëri po ndodh në një përqindje shumë të lartë nëse do të marrim totalin e atyre që janë vendimmarrje të ZAZ-ve. Unë jo më vonë se para një ore jam njoftuar nga anëtari ynë i ZAZ-së nr. 39 që me shumicë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

votash kjo ZAZ ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të dokumentacionit për anëtarin e QV-ve, që i përket Partisë Demokratike dhe Partisë Socialdemokrate, deri në datën 28.4.2023, ora 24.00. Në dijeninë time, me aq njohuri sa kam unë nga ligji elektoral shqiptar, flasim që afati i tyre ka mbaruar në datën 24. Unë nuk e kuptoj se me çfarë kompetence, force të ligjit disa persona të emëruar për të ushtruar detyra zgjedhore, të cilët kanë përgjegjësi edhe të karakterit penal, marrin iniciativa të kësaj natyre duke njoftuar subjektet që rriemëroni ose risillni dokumentacion, ndërkohë që afati i dokumentacionit dhe emërimi personave me detyra zgjedhore që mbajnë funksionin e anëtarit të QV-së ka mbaruar në datën 24. Thënë këtë, do të doja nga ana juaj, në mënyrë të menjëhershme të më jepni informacion lidhur me sa për qind dhe cilat kanë qenë ZAZ-të që kanë marrë këtë iniciativë. Pas këtij rezultati, nëse rezulton që kjo iniciativë, qoftë edhe një, siç e kam unë, unë kam më shumë se një, ky denoncim është bërë vetëm për 39-n, unë mendoj që është në 80% të ZAZ-ve në Republikën e Shqipërisë, do të doja nga ana juaj të merrni iniciativën për shkarkimin e personave që kanë abuzuar me detyrën duke dhënë kompetenca e duke shtyrë afate në tejkalim të afateve ligjore të përcaktuara nga ligjvënësi. Kjo gjë të bëhet e menjëhershme, të mos cenohet procesi zgjedhor, të mos bëhet diskriminues procesi zgjedhor. Duke qenë se mazhoranca e atyre që janë anëtarë të ZAZ-ve në dakordësi me njëri-tjetrin, në mënyrë të jashtëligjshme dhe të qëllimshme, marrin iniciativa të kësaj natyre, duke cenuar në vetëve integritetin, solemnitetin dhe votën e lirë nëpërmjet dhënies së afateve të paparashikuara në Kod, tej këtyre afateve, subjekteve politike, të cilat nuk kanë qenë akoma në gjendje, këtu tregojnë seriozitetin e tyre, për të sjellë dokumentacionin përkatës për personat që ata vetë kanë ngarkuar me detyra zgjedhore. Kërkoj nga ana juaj marrjen e masave deri në shkarkimin e personave që kanë bërë këtë abuzim dhe, në qoftë se kanë përgjegjësi penale në këtë rast, deri në ndjekjen penale të këtyre personave.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Celibashi: Zoti Sekretar, kemi ndonjë informacion në lidhje me këtë paraprakisht para se t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Partisë Demokratike?

Z. Y. Merhaj: Po, unë kam folur mbrëmë në darkë me drejtorin e administratës zgjedhore. Më ka thënë që në datën 24 ka mbaruar afati për plotësimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të Partisë Demokratike. Di që është bërë një shkresë për ta zëvendësuar.

Z. I. Celibashi: KZAZ-në...

Z. Y. Merhaj: Për të gjitha KZAZ-të, për anëtarët e QV-ve. Një shkresë po i drejtohet subjektit tjetër nëse nuk i plotëson. Janë duke përgatitur shkresën. Për momentin nuk mund të them është nisur apo jo shkresa.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. I. Sefa: Në dijeninë time, i nderuar zoti Komisioner, emrat janë dërguar. Është kërkuar nga KZAZ-ja plotësimi i dokumentacionit, siç është certifikata personale, po merret kontakt me personat dhe ky afat ka qenë për të sjellë vetëm certifikatat personale. Unë e kuptoj të gjithë këtë lojën, gjithë këtë dëshirë të madhe për ligjshmërinë, e kuptoj, jam i qartë dhe ku do të dalë, por në dijeninë time afati ka qenë vetëm për paraqitjen e certifikatave personale. Ka disa persona që aktualisht, siç jeni në dijeni, që kjo certifikatë del vetëm nga sistemi *e-albania* dhe nuk mund të merret fizikisht në organet e qeverisjes vendore. Duke qenë se disa persona që janë në zona të ndryshme nuk kanë mundësi aksesit në *e-albania* është bërë e mundur që të kenë një afat kohor vetëm për paraqitjen e kësaj certifikate. Kjo është

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

problematika. Unë jam i qartë në lidhje me gjithë diskutimin dhe me gjithë këtë vorbull që do të krijohet, por situata është e tillë. Në rast se mendohet që kjo është pengesë thelbësore për zhvillimin e procesit, ne do të marrim masa të menjëhershme për ta zgjidhur këtë ngërç, që mendoj se është një furtunë në gotë për qëllime të pastra elektorale nga një subjekt tjetër.

Z. I. Celibashi: Edhe një herë përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Komisioner! Në qoftë se një subjekt zgjedhor nuk garanton dot në 61 bashki kryetarët e bashkive, mendoni si do të garantojë ata që janë me detyra zgjedhore të mëposhtme, siç mund të jenë ata të KZAZ-së, GNV-së, QV-së e të gjitha me radhë. Sa po më vjen informacion nga administrata juaj në 54 KZAZ janë raportuar probleme të kësaj natyre dhe vetëm në 7 prej tyre, të paktën nuk e di nëse ky informacion është zyrtar, por po ma sjell një zyrtar juaji, është plotësuar dokumentacioni dhe nuk mund të themi vetëm një certifikatë e nxjerrë nga *e-albania*. Në qoftë se ligjvënësi ka parashikuar dokumentacion të caktuar në ligjin zgjedhor dhe në aktet nënligjore të bëra nga Komisioni Rregullator, ne të tjerët këtu jemi vetëm për t’i zbatuar, jo për t’i interpretuar ato që kjo është e vlefshme, kjo duhet, kjo tjetra nuk duhet, kjo përbën shkak, e kjo tjetra përbën pasojë. Jo, zoti Komisioner, siç ju thashë, nuk mund të tallemi me zgjedhësit në qoftë se nuk do të tregojmë integritet që nga momenti që jemi futur në këtë proces zgjedhor duke garuar me armë të barabarta, duke vënë në dispozicion sipas afateve të parashikuara në Kod çdo dokumentacion për çdo anëtar të propozuar nga subjektet politike, i bie që po tallemi me një proces të tillë dhe po cenojmë në vetvete një proces që është një proces normal votimi. Ju e dini fare mirë, keni një eksperiencë të madhe në këtë pozicion që problematikat e votimit në Shqipëri janë të shumta. Pse t’ia krijojmë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

vetes edhe këto të tjerat duke u dhënë akses disa personave që kanë një detyrë specifike, duhet t'ju përgjigjen juve dhe ligjit, për të abuzuar me afatet që ligjvënësi ka vënë në to. Përfaqësuesi, kolegu im, thotë vetëm një certifikatë, ndërkohë që statistikat flasin krejt ndryshe dhe flasin për pjesën më të madhe të ZAZ-ve dhe nuk është vetëm përfaqësuesi i kolegut që nënshkruan një shtyrje afati, por janë të gjithë anëtarët e tjerë, duke hequr anëtarin, përfaqësuesin e partisë sonë dhe të koalicioni, që ka votuar gjithmonë kundër, një shtyrje të afatit të palogjikshëm, duke mos abuzuar ai vetë me detyrën dhe duke abuzuar të gjithë të tjerët me detyrën e vet. Kështu, që ju lutem, pa e bërë shumë të gjatë, sepse e shoh që rendi i ditës është shumë i gjatë dhe ju keni shumë impenjime në këtë periudhë, ju lutem marrjen e masave deri në shkarkimin e personave dhe në qoftë se kanë përgjegjësi penale, mos të shohm që i mungon vetëm një certifikatë, por të shohim që ata qëllimisht e kanë bërë shtyrjen e afatit për të mos kaluar, ju e dini fare mirë se çfarë parashikon ligji, ku kalon dhe si kalon pastaj më vonë anëtari i QV-së. Faleminderit!

Z. I. Sefa: Fjalja e fundit i shpjegon të gjitha arsyet e ngritjes së kësaj furtune, që ndodh për herë të parë në 32 vjet zgjedhje. Fatmirësisht ne kemi qenë dhe e kemi atë eksperiencë sa të dimë se çfarë ka ndodhur më parë dhe KZAZ-ja është autonome në vendimmarrjet e saj për garantimin e procesit për zonën që ajo administron. E dyta, mendoj që e di se kush është zyrtari i KQZ-së që i ka dhënë këtë informacion dhe interesin personal që ai ka në dhënien e këtij informacioni dhe mënyrën sesi ndërhyr në vendimmarrjen e KZAZ-ve, në mënyrë të padrejtë duke mos marrë informacion dhe raportuar informacion, por duke orientuar vendimmarrjen e KZAZ-së. Dje jam vënë në dijeni për këtë zyrtar dhe e di fare mirë se kush është.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. A. Kaziqaj: Tani kërcënime të kësaj natyre për zhytarë që bëjnë punën e tyre, është një informacion publik, më falni, që mbahet nga ju, sepse ju e koordinoni, e kontrolloni, e menaxhoni dhe duhet ta çoni deri në fund. Tani më vjen keq që kemi arritur në disa ditë të errëta që nëpërmjet një vendimi të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve i falet partia disa njerëzve që nuk garantojnë dot as kryetarët e bashkive dhe as anëtarët e ZAZ-ve dhe QV-ve dhe vijmë këtu dhe bëjmë skena teatrale sot nuk është as ditë e shtunë as ditë e diel. Ju lutem, të parashikojmë atë që ligji ka vendosur, ligjvënësi ka vendosur dhe ne të tjerët jemi të gjithë në shërbim të tij.

Z. I. Celibashi: Për paritet radhësh.

Z. I. Sefa: Për paritet radhe, problemi është që ka parti politike tradicionale ka edhe parti politike domate që nuk rrinë dot në këmbë vetë, por duan një hu dhe kemi edhe këto partitë politike dhe më vjen mirë që kanë gjetur një hu ku të mbështeten.

Z. A. Kaziqaj: Unë nuk e di se çfarë do të thotë kjo fjala e fundit, nuk është në fjalorin shqiptar, nuk merrem me bujqësi, i nderuar. Jam përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë” jam jurist në profesion, nuk bëj batuta të kësaj natyre për të gëzuar pjesën e Myzeqesë, e cila na jep prodhime më të mira bujqësore. Fakti është që një problem është ai i një vendimmarrje të KAS-it, i cili ia fal nënkryetarit një parti në kapërcim të kompetencave të ligjit. Nuk dua ta zgjas më tej, se të gjithë jemi dëshmitarë në përditshmëri që ata 5 veta që kanë, ata kanë, nuk mund të fusin 10 veta kur kanë 5 veta, as anëtarë të KZAZ-së, as kryetarët e bashkive, as anëtarët e QV-së nuk kanë për t’i bërë, por i ndihmon bashkëvuajtësit politik Partia Socialiste për çdo gjë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Celibashi: Këshilla ime edhe miqësore është që ta kurseni këtë lloj retorike të paktën në këtë sallë pasi me siguri që keni plot ambiente të tjera ku mund ta prezantoni këtë retorikë. Qoftë edhe mënyra si e adresoni këtë retorikë, nuk besoj se i jep ndonjë vlerë të shtuar argumentit thelbësor të çështjes. Kjo është këshilla ime, përndryshe ju jeni të lirë të thoni çfarë të doni në këtë sallë pa u sanksionuar. Atëherë do të bëjmë të gjitha verifikimet që lidhen me këtë çështje për veprimtarinë dhe vendimmarrjet përkatëse të anëtarëve të KZAZ-së për anëtarë të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor të marrim masat që duhen marrë, qoftë të karakterit administrativ, por edhe kur është rasti edhe me sanksione.

Z. Y. Merkaç: Sapo mora informacion, disa KZAZ, i kanë dërguar partisë...

Z. I. Celibashi: Nuk do ta zgjasim më këtë.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

**Data 27.04.2023
Ora, 12:30**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medieve
Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të
për periudhën 14 prill – 22 prill 2023.”**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, Z. K. Puleri, Znj. V. Ballgjini,**
- **Parti Politike:** **BF (A. Kaziaj, F. Nuri), PD (I. Sefa)**
- **Të tjerë:** **KRIK, AKP (E. Tele, B. Ana), OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me rendin e ditës.

Z. A. Kaziaj: Zoti Kryetar, ju uroj ditë të mbarë! Më duhet të largohem. Është kolegu Franci Nuri. Me dinjitetin më të madh do të bëjë përfaqësimin e subjektit dhe koalicionit. Faleminderit për fjalën që më keni dhënë jashtë rendit të ditës! Punë të mbarë! Presim përgjigje, duke parë dhe intensitetin, dhe atë që është në vetvete ndjeshmëria e çështjes, do të donim një përgjigje sa më shpejt të mundeni.

Z. I. Celibashi: Do të keni komunikimin me stafin dhe administratën e KQZ-së, e cila është e gatshme dhe e hapur, pavarësisht ndonjë rezerve që jam i sigurtë që në thelb nuk e ka edhe Indriti, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

A. Kaziaj: Ato nuk janë rezerva, ato janë kërcënime, zoti Komisioner. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ditë të mbarë! Po Valbona, fjala është për ju për prezantimin e raportit të AMA-s për pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga operatorët radiotelevizivë për periudhën 14 prill -22 prill.

Znj. V. Ballgjini: Neni 78 i ligjit të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar parashikon të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore. Në nenet 80, 81, Kodi Zgjedhor parashikon rregullat e pasqyrimin të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore dhe edicionet informative në radiotelevizionin publik. Neni 83 i Kodit Zgjedhor përcakton se Këshilli Drejtues i RTSH-së, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, cakton minutazhin në dispozicion të çdo partie politike pjesëmarrëse në zgjedhje në bazë të të dhënave të paraqitura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për partitë e regjistruara. Gjithashtu, ky Këshill cakton në mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shortin për vendosjen e segmenteve orare për çdo parti politike të regjistruar në zgjedhje. Neni 84 i Kodit Zgjedhor parashikon se në fushatat zgjedhore në radiot dhe televizionet private përcaktohet qartë të rregullat e pasqyrimin të fushatës zgjedhore minutazhi politik transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike qendrore apo vendore, pasqyrimi veprimtarisë së partive joparlamentare në marrëdhënie me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të urdhëruar entin rregullator për të proceduar me bllokimin e transmetimeve në rast se konstatohen shkelje. Në nenin 85 të Kodit Zgjedhor parashikohet monitorimi i fushatës zgjedhore në medie, i cili kryhet nga enti rregullator në këtë rast AMA, të cilët, në zbatim të pikës 4, kanë detyrimin të pasqyrojnë gjetjet e veta nga procesi i monitorimit në raporte të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

detajuara dhe t'ia paraqesin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë. Raportet shoqërohen sipas rastit me propozime për masa administrative. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar raporte ditore dhe raporti përmbledhës që do të marrim në shqyrtim sot nga periudha 14-22 prill 2023. Në raportin e parë të dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra në raportin përmbledhës AMA vëren jo vetëm treguesit e monitoruar, por edhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi depozitimin në AMA, të përmbajtjeve të transmetuara OSHMA-të, kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim për transmetimet e lajmeve hapësirën për çdo aktor politik, kohën e monitorimit të OSHMA-ve për transmetimin e emisioneve, reklamat politike, si dhe zbatimin e raportit gjinor në mbulimin mediatik për kandidatët apo subjektet zgjedhore. Në lidhje me treguesit e depozitimit të regjistrimeve në AMA, në pikën 6 të nenit 85 të Kodit Zgjedhor radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë të gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto transmetime ruhen deri në mbarim dhe 10 muaj më vonë nga data e zgjedhjeve dhe vihen me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me njëherë në dispozicion të saj. Detyrimin për depozitimin e transmetimeve të çdo dite, parashikohet në metodologjinë e monitorimit të medias audiovizive. Sipas OSHMA-ve vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese këto OSHMA, janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese. Në bazë të vendimit nr. 26, datë 25 04.2023 të AMA-s rezulton se 4 subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar, pasi nuk kanë depozituar regjistrime për këtë periudhë 14-22 prill 2023. AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këto OSHMA të procedohet me marrje masash administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, AMA

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

informon se 4 ofrues të shërbimeve mediatike dhe ose audiovizive kanë depozituar regjistrime, por jo për të gjitha ditët ndërmjet kësaj periudhe. AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'iu tërheqë vëmendjen këtyre OSHMA-vë për respektimin e plotë të këtij detyrimi. Lidhur me treguesin reklama politike, në pikën 7 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, reklammat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15-18 dhe nga ora 21-24 të programit ditor. Referuar vendimit të AMA-s të datës 25.04.2023 rezulton se: 2 subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar, pasi kanë transmetuar reklama jashtë fashave orare të lejuara. Në këtë pikë AMA, në fakt, identifikon tri subjekte audiovizive, por nga shqyrtimi raporteve ditore që ne kemi në dispozicion një subjekt audioviziv, në fakt, rezulton se ka transmetuar reklamën politik e brenda fashës orare të lejuar. Ama i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'iu kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike në kohën e ndaluar. Sa i takon vlerësimin gjinor AMA i propozon KQZ-së t'iu tërheqë vëmendje të gjitha OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore. Pas verifikimeve përkatëse në dokumentacionin në tërësi, në lidhje me shqyrtimin e raportit të AMA-s për periudhën 14 prill 2023- 23 prill 2023 konstatohet se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara, referuar neneve 79, 80, 81, 83, 84, dhe 85 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të nenit 19 i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e masave kundrejt OSHMA-ve të raportuara nga AMA.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike, a keni diskutime në lidhje me këtë raport?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Sefa: Raporti është i qartë, zoti Komisioner. Nuk kemi në lidhje me problematikën ngritur nga AMA-n, sepse është institucioni përkatës që bën monitorimin e këtyre, por do parë fakti çfarë arsyesh këto OSHMA që nuk kanë raportuar, sepse, për shembull, për njërin që kam dijeni është në ndryshim e sipër pronësia dhe nuk asnjë informacion në lidhje me detyrimin për të bërë transmetim. Megjithëse unë jam në dijeni që nuk ka transmetuar asnjë aktivitet politik gjatë kësaj periudhe, sepse është në ristrukturime sipër, përveç spotit të KQZ-së, pra përveç atij nuk ka transmetuar asgjë tjetër.

Z. I. Celibashi: Për kë operator e keni fjalën?

Z. I. Sefa: Më duket TV Klaudiana.

Z. I. Celibashi: A ka diskutime të tjera lidhur më këtë pikë të rendit të ditës? Nuk ka. Atëherë, do t'i vlerësojmë gjetjet e këtij raporti dhe në ditët e ardhshme do të marrim vendim në lidhje me gjetjet e këtij raporti.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

**Data 27.04.2023
Ora, 12:37**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press”, Shoqërisë “ Last News Media Network”, Televizionit TV1 CHANNEL”, “ABC NEWS”, “ Light Studio Agency” dhe MCN TELVIZION” për vëzhgimin për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Z. K. Puleri, Znj. V. Ballgjini,**
- **Parti Politike:** **BF, PD, ZVA Korçë, Bashkia Krujë**
- **Të tjerë** **KRIK, AKP, OSBE, ODIHR, Helsinki**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, shqyrtimin e kërkesës për regjistrim, për akreditim të vëzhguesve për disa medie. “Associated Press”, Shoqërisë “ Last News Media Network”, Televizionit TV1 CHANNEL”, “ABC NEWS”, “ Light Studio Agency” dhe “MCN TELVIZION”. Këto janë.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, Agjencia e lajmeve “Associadet Press” ka paraqitur kërkesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 6 gazetarëve dhe operatorëve.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Celibashi: Shkurt vetëm a janë në përputhje me kërkesat e lejimit.

Z. Y. Merkaj: Po të gjitha kërkesat e paraqitura për akreditimin e gazetarëve dhe të operatorëve janë në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe si rrjedhim do të pranohen. Bashkëngjitur keni projektvendimin për miratimin.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive janë dakord. Miratohet lista e vëzhguesve për “Associated Press”, Shoqërisë “Last News Media Network”, Televizionit TV1 CHANNEL”, “ABC NEWS”, “Light Studio Agency” dhe “MCN TELVIZION”.

Vendimi nr. 417

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

**Data 27.04.2023
Ora, 12:39**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin adminsitrativ të denoncimeve nr. 172 ID, 173 ID, 174 ID dhe 175 ID të koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ndaj Bashkisë së Cërrikut”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, M. KOJA.**
- **Parti Politike:** **BF, PD,**
- **Të tjerë** **KRIIK, AKP, OSBE, ODIHR,
Helsinki, Bashkia Krujë**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimeve të organizatës KRIIK. Paraqitini të përmbledhura, pra, denoncimet që janë për bashkitë e Cërrikut, Poliçanit, Kamzës, Devollit, Fierit, Krujës, Lezhës, Elbasanit dhe Asgjësisë Shtetërore të Pyjeve.

Znj. I. Osmanaj: Kemi administruar denoncimet për 7 veprimtari publike për 6 institucione për mosraportim të veprimtarive publike apo për kryerje të veprimtarisë publike përpara datës së raportuar. Përkatësisht për Bashkia e Cërrikut është denoncuar për kryerjen e një aktiviteti përpara datës së raportuar, e regjistruar me

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

numër regjistri 174 ID dhe 175 ID. Denoncues është KRIK-u, nëpërmjet së cilës denoncon inspektim punimesh në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Dasar, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë së Cërrikut dhe drejtuesin politik të qarkut të Elbasanit, zotin Gjikhuri. Aktiviteti është raportuar në ndërfaqe në datën 4 mars për të zhvilluar në datën 10 mars. Denoncuesi pretendon se zoti Gjikhuri ka postuar në datën 6 mars në faqen e tij në *facebook* foto dhe video të këtij aktiviteti. Në datën 10 mars është postuar në faqen e *facebook-ut* të bashkisë dhe në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë së Cërrikut. Denoncimi i dytë ka të bëjë me inspektimin e punimeve në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike në fshatin Selvias, me pjesëmarrjen po të kryetarit të bashkisë, si dhe të zotit Damian Gjikhuri. Aktiviteti është i raportuar nga Bashkia e Cërrikut në datën 25 shkurt për në datën 6 mars. Denoncuesi pretendon se zoti Gjikhuri e ka postuar këtë aktivitet në faqen e tij në *facebook* në datën 4 mars. Në datën 7 mars është postuar në faqen e *facebook-ut* të bashkisë dhe të kryetarit të bashkisë, pra rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së ka qenë ndoshta plotësuar qëllimisht gabim. Pas administrimit të denoncimit i kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për Bashkinë e Cërrikut, por nuk kemi administruar përgjigje. Për këtë arsye janë thërritur sot për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, për të dhënë edhe pretendimet e tyre. Kemi Bashkinë e Krujës, për një veprimtari publike të paraportuar, regjistruar me numër regjistri 215 ID. Denoncues është KRIK-u nëpërmjet së cilës denoncon aktivitet me rastin e ditëlindjes së artistit Ramiz Kovaçi, organizuar nga Bashkia e Krujës, ku vihet re edhe prania e një numri të gjerë pjesëmarrësish. Pas kërkesës për informacion drejtuar personit përgjegjës për Bashkinë e Krujës nuk kemi administruar përgjigje dhe për këtë arsye po këta persona janë thërritur për të marrë pjesë në seancën e sotme dëgjimore. Bashkia e Devollit për një veprimtari publike të paraportuar, ku denoncuesi është KRIK-u

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

është regjistruar me numër regjistri 213 ID. Objekti i këtij denoncimi është aktivitet me rastin e ditës ndërkombëtare të poezisë, të organizuar nga Bashkia e Devollit në bashkëpunim me gjimnazin "Fuat Babani" në Bilisht. Pas administrimit të denoncimit, në kuadër të procesit administrativ, i kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për Bashkinë e Devollit, po nuk kemi administruar pretendime, janë thërritur për të marrë pjesë në seancën e sotme dëgjimore për të dhënë shpjegimet e tyre, por nuk janë paraqitur. Kemi Bashkinë e Fierit e denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar, regjistruar me numër regjistri 214 ID, ku denoncues është KRIK-u. Objekti i këtij denoncimi ka të bëjë me vizitën e kryetarit të Bashkisë së Fierit dhe deputetit zotit Taulant Balla në biznesin e zotit Robert Eci në njësinë administrative. Kemi Bashkinë e Fierit. Pala pretendon se nuk kemi të bëjmë me një aktivitet publik, por me një vizitë të qytetarit të parë të bashkisë në disa sipërmarrje, me synim krijimin e një panorame të plotë të situatës së sipërmarrjeve private. Në këtë vizitë nuk ka patur media dhe as ka qenë i hapur për publikun, por thjesht një bashkëbisedim miqësor me drejtuesit e sipërmarrjeve. Nuk ka qenë qëllim ofrimi i ndonjë ndihme apo lehtësie nga ana e qeverisjes vendore apo qendrore dhe as të promovojë asnjë aktivitet politik. Kjo vizitë është publikuar në rrjetin social *facebook* të zotit Armando Subashi. Këto janë pretendimet e përfaqësuesit të Bashkisë së Fierit. Janë thërritur sot në seancë për të thënë edhe pretendimet e tyre përfundimtare, por rezulton që nuk janë paraqitur. Kemi Bashkinë e Lezhës, e denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar, e regjistruar me numër regjistri 218 ID. Denoncuesi sërisht është KRIK-u që denoncon takimin e kryetarit të bashkisë me komunitetin e qytetit të Lezhës, ku theksohen arritjet e katër viteve të fundit për këtë qytet dhe sfidat për 4 vitet e ardhshme. Pas administrimit të denoncimit në kuadër të hetimit administrativ i është dërguar kërkesa për informacion personit përgjegjës për Bashkinë e Lezhës, nuk kemi administruar

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

pretendimet e tyre, janë thërritur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike po nuk janë paraqitur. Kemi Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, denoncuar për një veprimtari publike të paraportuar, regjistruar me numër regjistri 233 ID. Denoncuesi është KRIK-u, nëpërmjet së cilit pretendon: përfundimi i punimeve të pyllëzimit në ekonominë pyjore në vendin e quajtur Dombrov, ku morën pjesë drejtori i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, zoti Artur Kala, bashkë me kryetarin e Bashkisë së Devollit, zotin Eduart Duro. Aktiviteti publik është transmetuar në një media, i është dërguar kërkesa për informacion, sikurse dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe Bashkisë së Devollit për të dhënë pretendimet e tyre. Agjencia Kombëtare e Pyjeve në pretendimet e saj të vëna në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bën me dije se kjo veprimtari nuk është organizuar nga institucioni ynë. Ne kemi qenë thjesht pjesëmarrës. Projekti i pyllëzimit është hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit të Bashkisë së Devollit, i cili ka nisur të zbatohet që prej vitit 2022. Ky aktivitet ishte në kuadër të projektit të lartpërmendur dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve u kërkua me rastin e përfundimit të pyllëzimit në zonën e Dombrovës. Palët janë thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike dhe rezultoi që Agjencia Kombëtare pyjeve ka ardhur me përfaqësuesit e saj, sikurse ka depozituar edhe pretendime përfundimtare me shkrim. Gjithashtu, kemi denoncime që kanë të bëjnë me shpërdorimin e burimeve publike për Bashkinë e Cërrikut, për 2 veprimtari publike të regjistruara me numër 172 dhe 173 ID. Denoncuesi është KRIK-u nëpërmjet së cilës denoncon inspektimin e punimeve në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike në fshatin Selvias, Klos me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë së Cërrikut dhe inspektimi i punimeve të kryetarit të bashkisë në fshatin Shalës. Këto aktivitete janë përdorur për diskutime elektorale dhe premtime të drejtpërdrejta për zgjedhjet e datës 14 maj dhe janë postuar nga të 2 titullarët, respektivisht në rrjetet e tyre sociale. I kemi dërguar

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

kërkesën për informacion Bashkisë së Cërrikut, por nuk kemi administruar asnjë përgjigje nga ana e tyre. Janë thërritur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por nuk janë paraqitur. Kemi denoncim për Bashkinë e Poliçanit për një veprimtari me përmbajtje elementesh elektorale, regjistruar me numër 180 ID. Denoncuesi është KRIK-u nëpërmjet të cilin pretendon për takimin e kryetarit të Bashkisë së Policanit dhe drejtuesi politik të qarkut Berat, sikurse dhe ministrit të Brendshëm, zotit Blendi Çuçi me të rinj aktivistë të Partisë Socialiste në Poliçan. Takimi është postuar në faqen zyrtare të Bashkisë së Poliçanit. I kemi dërguar kërkesën për informacion personit përgjegjës për Bashkinë e Poliçanit, por nuk kemi administruar përgjigje. Palët janë thërritur për të marrë pjesë sot në seancën publike, por nuk janë paraqitur. Kemi denoncim për Bashkinë e Kamzës për 2 aktivitete me përmbajtje elementesh elektorale, regjistruar me numër regjistri 182 dhe 183 ID. Denoncuesi është KRIK-u dhe objekt i këtij denoncimi është takimi i kryetarit të bashkisë, zotit Rakip Suli, dhe të deleguarës politike, zonjës Lindita Nikolla, me strukturat e Partisë Socialiste në Kamëz. Postimi është i datës 4 mars në faqen zyrtare të bashkisë dhe takimi i dytë ka të bëjë me takimin e kryetarit të Bashkisë së Kamzës dhe të deleguarës, zonjës Lindita Nikolla, me shtabin e Partisë Socialiste në Kamëz, ku u diskutua mbi organizimin e Partisë dhe strukturat për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Postimi i datës 17 shkurt është në faqen zyrtare të institucionit të bashkisë. I kemi dërguar kërkesën për informacion Bashkisë së Kamzës, por nuk kemi administruar përgjigje. Kemi thërritur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezulton që nuk janë paraqitur. Kemi Bashkinë e Elbasanit, denoncuar për një veprimtari për përdorim të burimeve publike, regjistruar me numër regjistri 219 ID, ku denoncues sërish është KRIK-u. Objekti i këtij denoncomi është inspektim punimesh për rehabilitimin e plotë të rrugës “Theofan Popa” në lagjen Hazhias. Pretendimet e KRIK-ut janë se takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Bashkia e Elbasanit, ku dhe deklarohet të gjithë pjesëmarrësit. Përveç përdorimit të sloganeve elektorale të Partisë Socialiste, kemi dhe një sërë artikulimesh elektorale në mbështetje të kandidatit, zotit Llatja, dhe të subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Në faqen zyrtare *facebook* të kryetarit të bashkisë, si dhe të drejtuesit politik të zotit Gjikhuri gjenden edhe disa postime të aktiviteteve të Bashkisë së Elbasanit, në të cilat ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik, ku pothuajse në të gjitha këto takimet ky i fundit bën fushatë të hapur elektorale. Kemi dërguar kërkesën për informacion, por nuk kemi administruar përgjigje. Kemi thërritur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezultoi që nuk janë paraqitur. Kemi denoncimin e regjistruar me nr. 222 ID dhe nr. 202 ID. Denoncimi i parë është i Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe denoncimi i dytë është i deputetes, zonjës Albana Vokshi, të cilët denoncojnë një veprimtari për përdorim të burimeve publike. Objekti i këtij denoncimi, i përmbledhur, për të dyja denoncimet, konsiston se zyra vendore arsimit parauniversitar ka adresuar kërkesa të përsëritura drejt stafeve pedagogjike për realizimin e një tablele *excel*, ku përfshihen të gjitha të dhënat mbi mediet sociale të përdorura nga këto institucione. Kërkohej informacion, gjithashtu, edhe për numrin e ndjekësve dhe numrin e postimeve për veprimtaritë shkollore, ripostimet në llogaritë e rrjeteve sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kemi administruar nëpërmjet përgjigjeve pretendimet e ZVA-së Korçë sikurse edhe pretendimet e Ministrisë së Arsimit, të cilat do t'i shpjegojnë edhe në këtë seancë, pasi janë thërritur palët dhe rezultoi që janë të pranishëm. Kemi denoncimin ndaj Bashkisë së Tropojës për një veprimtari publike regjistruar me numër 226 ID, një veprimtari me objekt përdorimin e burimeve publike, ku denoncues është një sinjalizues. Denoncimin e tij e ka denoncuar në ndërfaqen e dedikuar në KQZ, për këtë qëllim: "Denonco". Objekti i këtij denoncimi është kryetari i Bashkisë së Tropojës, për përdorim të institucioneve

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

arsimore dhe shëndetësore për veprimtari politike. Bashkë me drejtues të strukturave të Partisë Socialiste kanë zhvilluar aktivitetet politike në shkollën 9-vjeçare, njësi administrative Vujan, ndërsa më herët, në muajin shkurt, kryetari ka promovuar ndërtim ambulance në fshatin Markaj, ku nuk deklaroi burimet e fondeve për ndërtimin e saj. Kemi dërguar kërkesat për informacion dhe nuk kemi administruar asnjë përgjigje. Gjithashtu, kemi denoncimin e regjistruar me numër 227 ID sërish për Bashkinë e Tropojës. Denoncimi është sërish nga një sinjalizues për një veprimtari për përdorim të burimeve publike. Objekti i këtij denoncimi është hapja e procedurave të prokurimit pa patur fonde në dispozicion në afat likuidimi 3-vjeçar vetëm 2 muaj përpara fushatës. Kemi dërguar kërkesë për informacion në kuadër të hetimit administrativ. Nuk kemi administruar asnjë përgjigje. Kemi thërritur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por nuk janë paraqitur. Kemi denoncim për Bashkinë e Roskovecit, regjistruar me numër ID 237. Objekti i këtij denoncimi është veprimtaria për përdorim të burimeve publike. Objekti i këtij denoncimi është inspektim punimesh për rikualifikimin urban të qendrës së Marinzës. Aktiviteti është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në datën 13 mars. Denoncuesi pretendon se takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga Bashkia e Roskovecit, por nuk deklarohet se pjesëmarrës do të ishte dhe zoti Taulant Balla. Në këtë aktivitet nuk kanë munguar as sloganet elektorale të Partisë Socialiste. Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë së Roskovecit, si dhe drejtuesit politik të qarkut, zoti Balla, gjenden disa postime të aktivitetet të Bashkisë së Roskovecit, në të cilat ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik. Pas kërkesës për informacion, personi përgjegjës për Bashkinë e Roskovecit i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim dhe bën me dije se ky aktivitet nuk është politik, por është në kuadër të mbarëvajtjes dhe kontrollit të punimeve në këtë objekt, si pjesë e përditshme e procesit të punës së kryetarit të bashkisë. Në raportim thuhet se ky aktivitet është i

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

hapur për publikun dhe nuk kemi patur as konfirmim të pjesëmarrësve. Palët janë thërritur për të marrë pjesë sot në seancën publike, por rezulton që nuk janë paraqitur. Në seancë janë paraqitur përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, përfaqësuesi i Bashkisë së Krujës, përfaqësues nga ZVA-ja Korçë, dhe përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për të dhënë edhe pretendimet e tyre përfundimtare mbi këtë çështje.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Celibashi: Po, të Bashkisë Krujë nuk i kemi sot në rendin e ditës, apo jo? Çfarë numri i ID është kjo? Po, drejtë, 215 ID, po. Dakord, mirë, atëhere sipas rradhes që jeni ulur aty, pastaj prezantohuni gjithsecili prej jush, edhe pretendimet tuaja për çarë dëgjuat dhe çfarë ju është referuar nëpërmjet email-it. Po.

Përfaqësuesi AKP: Përshëndetje, i nderuar Komisioner! Duke ju referuar arsyes mosraportimit të veprimtarisë që është objekti

Z. I. Celibashi: Kë institucion përfaqëson?

Përfaqësuesi AKP: Agjensinë Kombëtare të Pyjeve, përfaqësuesi ligjor. Pra duke ju referuar arsyes së mosdeklarimit të veprimtarisë objekt denoncimi Koalicioni për Reforma dhe Integrim dhe institucionit të konsoliduara KRIIK, në raportin e periudhës 24-30 mars, të botuara nga ana e saj, dëshiroj të sqaroj, siç u sqarua dhe në relacionin e relatores të Komisionit që aktiviteti nuk është organizuar nga Agjensinë Kombëtare e Pyjeve, Agjensinë Kombëtare e Pyjeve menjëherë mbas marrjes së kërkesës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për sqarime për këtë çështje, brenda afatit ligjor ka kthyer përgjigje me shkrim, në email, më pas dhe ka depozituar pretendimet dhe parashtrimin e tij, duke bashkëlidhur dhe faktet shkresore që provojnë që nuk ka përgjegjesi për mosnjoftimin. Pra ky aktivitet është zhvilluar nga Bashkia Devoll, ekzaktësisht nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit të Bashkisë Devoll, në kuadër të një projekti të miratuar më parë, gjatë, të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Devoll të miratuar në fillim të vitit 2022, është një projekt që ka ndjekur të gjithë hapat ligjorë dhe e kemi të dokumentuar që projekti është miratuar nga Këshilli Bashkiak sipas ligjit, është konfirmuar nga Prefekti, ka marrë miratimet përkatëse sipas instancave shtetërore dhe është i buxhetuar dhe është

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

ndjekur sipas fazave për kryerjen e pyllëzimeve që dihet, nga çdo ekspert i fushës së pyjeve, bëhen çdo dhjetor deri në fund të marsit. Ne kemi qënë në rrolin e kontrolluesit apo monitoruesit siç është misioni i përcaktuar me ligjin 57/2020 për pyjet, ashtu dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin dhe funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Pyjeve, të cilët ne kemi detyrimin ligjor për të asistuar, për të monitoruar të gjitha projektet, të gjitha veprimtaritë zbatuese pra, që ndikojnë apo përmirësojnë fondin pyjor kombëtar. Përsa më lartë thuhet, duke qënë që ne nuk kishim detyrim ligjor për të raportuar pranë KQZ-së për këtë aktivitet, dhe këtë detyrim e ka bashkia, nuk kemi një përgjegjësi ligjore apo nuk kemi bërë një shkelje ligjore të parashikuar nga dispozita përkatëse të Kodit Zgjedhor. Përsa më lart pra, përfundimisht kërkoj pushimin e ndëshkimit administrativ ndaj Agjensisë Kombëtare të Pyjeve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, pra sipas jush nuk ka qënë aktiviteti juaj dhe nuk keni patur detyrime për ta raportuar, jeni ftuar në aktivitetin që e ka organizuar dikush tjetër, dakord, mirë, falemindrit. Vazhdojmë institucione të tjera me rradhë, përfaqësues të partive politike? Po.

Përfaqësuesi Bashkisë Krujë: I nderuar Kryetar, unë përfaqësoj këtu Bashkinë Krujë. Lidhur me referimin numër 215 nga KRIIK ndaj Bashkisë Krujë. Është referuar një ankesë, apo një denoncim lidhur me një aktivitet publik, mbajtur me datë 22 mars sipas KRIIK-ut, atëhere e para e gjësë është që Bashkia Krujë i është përgjigjur nëpërmjet email-it, në adresën denoncimetKQZ.gov.al, në datë 28 mars, ora 1:33, nëpërmjet këtij email-i. E para, e dyta Bashkia Krujë në datë 22 mars 2023 nuk ka organizuar asnjë aktivitet publik, por ka marrë pjesë në një aktivitet i cili është krijuar, është ftuar nga familja e zotit Kovaçi në inagurimin e bustit të Nderit

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

të Kombit Ramiz Kovaçi, i cili përkonte dhe me ditëlindjen e tij, dhe ky aktivitet ka qënë programuar nga familja shumë kohë përpara. Ky bust u vendos në pedonalen e qytetit të Krujës me kontributin dhe donacionin e familjes Kovaçi dhe në ceremoninë e inagurimit morrën pjesë të ftuar nga familja Kovaçi, një nga to ishte dhe institucioni i Bashkisë Krujë, përtej Bashkisë Krujë kishte dhe si ambasadorja e Republikës së Bullgarisë në Shqipëri, dhe Bashkinë Krujë e përfaqësoi zoti Ilir Lozi i cili është nënkryetar i Bashkisë Krujë jo kryetari i cili është dehur kandidat në zgjedhjet e 14 majit. Si provë materiale nga KRIIK është marrë një postim nga mediat sociale e kryetarit të bashkisë, ndërsa sa i përket mediatizimit, Bashkia Krujë nuk ka lançuar asnjë ftesë për mediat lokale dhe thjesht ka patur një korespondent lokal të ABC News-it i cili është ftuar nga ana e familjes, dhe nuk ka pasur asnjë ftesë apo komunikim zyrtar nga zyra për marrëdhëniet me publikun të Bashkisë Krujë, sepse kjo nuk është aktivitet i zhvilluar nga Bashkia Krujë, por thjesht Bashkia Krujë si pjesë e qytetit dhe komunitetit është ftuar për të marrë pjesë në këtë aktivitet, gjë që e cila mund të dëshmohet dhe me të thirrur apo me kontakt me familjen Kovaçi apo dhe me gazetarët e korespondentët e tjerë të ftuar . Kjo është pjesa e parë dhe kjo ka qënë jashtë fushatës elektorale dhe në fakt këtë kthim përgjigje ne e kemi bërë brenda afatit të kërkuar nga adresa zyrtare e KQZ-së. Kjo është si pjesë, dhe pjesa tjetër është që nuk kemi angazhuar apo nuk kemi mbajtur apo qoftë dhe me prezencën e kryetarit të Bashkisë Krujë, në këtë rast. Mund të kontaktoni me familjen për rasti konkret, thjesht kemi qënë të ftuar biles kemi pasur dhe një fjalë rasti sipas referimit nga familja, kaq. Shumë faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit juve. Përfaqësues të institucioneve të tjera, të cilat u dëgjuan në referim? Po kemi? Po, ju lutem lirojini vëndin, mund të largoheni për

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

mos t'ju marrë më shumë kohë, faleminderit. Bashkë mbaruam, po. Ju lutem prezantohuni.

Përfaqësuesi ZVA Korçë: Përshëndetje i nderuar, unë jam përfaqësuese e Zyrës Vendore Arsimore Korçë, Pustec. Paraprakisht do doja të thoja që në seancën e datës 5 prill janë paraqitur të njëjtat pretendime nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, si ato që do të parashtroj edhe unë sot, por e shoh të rëndësishme dhe kryesorë që t'i parashtroj edhe njëherë për të zbuluar qëllimin e mbledhjes së informacionit mbi institucionet tona arsimore për veprimtaritë e tyre në faqet e rrjeteve sociale. Dua të them që ky informacion është bërë së pari dhe kryesisht për të identifikuar faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitar, të cilat administrohen nga drejtuesit e shkollës, për t'i diferencuar këto nga faqet e tjera që nuk administrohen nga autoritetet drejtuese të institucioneve arsimore. Theksojmë se kjo kërkesë është bërë përmes email-it dhe është dërguar te adresat zyrtare të email-it të institucioneve arsimore, adresa këto që administrohen nga drejtuesit e shkollës, dhe nuk është bërë drejtuar stafeve pedagogjike siç pretendohet në denoncim. Informacioni i kërkuar mbi numrin e postimeve për veprimtaritë shkollore synon verifikimin nëse këto faqe po përdoren për qëllime informimi mbi veprimtarinë e institucioneve publike parauniversitare apo jo. Qëllimi i faqeve zyrtare të këtyre institucioneve është fillimisht shpërndarja e informacionit në kohë reale ku përfshin informacionet e shpërndara në faqen e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, mbi aktet nënligjore të miratuara prej saj, në lidhje me arsimin parauniversitar, dhe qëllimi tjetër është që faqet zyrtare të institucioneve të promovojnë aktivitete social-kulturore. Është detyre e Zyres Arsimore Vendore të verifikoj nëse përmbajtja e postimeve është brënda kornizave të aktiviteteve të institucioneve të arsimit parauniversitar, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Po kështu dua të theksoj që në vijim të shkresës numër 138 të Komisionit qendror të Zgjedhjeve dhe të shkresës me numër 730/1 të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit drejtuar Zyrave Vendore të arsimit parauniversitar, mbi ndalimet e zhvillimit të veprimtarive partiake dhe fushatës zgjedhore në institucionet arsimore, qëllimi i grumbullimit të këtij informacioni ishte që të monitorohej zbatimi i kufizimeve të vendosura nga KQZ-ja, para zgejdhjeve me qëllim mospërdorimin e këtyre faqeve të institucioneve arsimore për postime me karakter politik. Dhe pika e fundit, në lidhje me pretendimin mbi kopshtet, pra se ky informacion është kërkuar edhe nga kopshtet, sqarojmë se sipas pikës 12, të nenit 23, të Ligjit numër 139/2015, për vetqeverisjen vendore të ndryshuar, bashkitë janë përgjegjëse për territorin e juridiksionit të tyre për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor, pra në kopshte dhe në çerdhe, pra nuk është detyre funksionale e Zyrës Vendore Arsimore. Ju faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Institucione të tjera? Nuk kemi, po Komiteti Shqipëtar i Helsinkit.

Përfaqësuesi Komitetit Shqipëtar të Helsinkit: I nderuar Komisioner, mund t'i bëj zonjës dy pyetje para se të nis relatimin? Në rradhë të parë doja ta pyesja se cila është baza ligjore nëpërmjet të cilës ministria apo drejtoria e arsimit parauniversitar juve ju kërkon që të bëni një raportim të tillë, apo plotësimin e tabelës exel, pyetja e parë, dhe pyetja e dytë ju thatë se qëllimi i kësaj veprimtarie lidhet me monitorimin e faqeve të shkollave për të mos u përdorur për fushatë elektorale, a i kemi monitoruar ju këto faqet e këtyre shkollave dhe a kanë ato postime të natyrës politike dhe elektorale?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Përfaqësuesi ZVA Korçë: Përsa i përket pretendimit të parë dua të theksoj që në bazë të rregullores për funksionimin e zyrave vendore për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, neni 31, pika b, është detyrë e këtyre institucioneve, këtyre zyrave, të mbikqyrin eprimtarinë e përditshme dhe funksionimin e institucioneve arsimore për mbushjen e detyrave administrative dhe për rregullsinë e procesit. Përsa i përket pikës së dytë, gjatë gjithë kësaj kohe, po, është bërë monitorimi i të gjithave faqeve zyrtare të institucioneve nën juridiksionin e Zyrës Vendore Arsimore Korçë, Pustec, mbi veprimtaritë e tyre.

Përfaqësuesi Komitetit Shqipëtar të Helsinkit: Dhe si ju rezulton kanë to shpërndarje të materialeve propagandistike me përmbajtje politike?

Përfaqësuesi ZVA Korçë: Dhe rezulton që jo nuk kanë informacione të tilla, shpërndarje të materialeve të tilla.

Përfaqësuesi Komitetit Shqipëtar të Helsinkit: Faleminderit për përgjigjen, i nderuar Komisioner fillimisht komiteti Shqipëtar i Helsinkit është vendosur në dijeni të kësaj problematike për ZVA Korçë, por nga verifikimi dhe zhvillimi i seancës publike të datës 5 prill, ne jemi, kemi kryer një hulumtim akoma dhe më të gjerë dhe rezulton se kjo është një problematikë e shtrirë në nivel kombëtar. Sa i përket mënyrës se si kjo problematikë është evidentuar nga ne, rezulton se kërkohen të dhëna të cilat lidhen me numrin e ndjekësve në faqe, numrin e postimeve për veprimtarinë shkollore, numrin e ripostimeve prej postimeve të kryera në llogarinë e rrjeteve sociale dhe i gjithë ky informacion nuk kërkohet për shpërndarje të informacioni zyrtar të Ministrisë së Arsimit, por kërkohet shpërndarja dhe informacioni për publikime të numrit të postimeve të ministres, pra tek tabela excel

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

që ne kemi depozituar, te kolona e fundit evidentohet qartë se kërkohet informacion për shpërndarjet e profilit zyrtar të ministres. Kujtojmë se profili personal i ministres së nderuar, në të drejtën e saj të ligjshme, përdoret edhe për zhvillimin e aktiviteteve politike, pra aty pasqyrohet fushata sepse ministria është një person politik dhe është një deputete, por çfarë ndodh, ky detyrim i cili sipas nesh është i kamufluar ka bërë që veprimtaria politike e ministres të pasqyrohet në mënyrë të paligjshme edhe në profilet e shkollave. I referohemi faqes zyrtare në facebook, të Zyrës Vendore e Arsimit parauniversitar, Korçë, Pustec, ku ka shpërndarë postimin e ministres në një pjesëmarrje në krahë të kandidatit të Bashkisë së Elbasanit, zoti Gledian Llatja dhe drejtuesit politik të Partisë Socialiste të qarkut zotit Gjiknuri. Është shpërndarë gjithashtu nga kjo zyrë edhe ministrja në krahë të kandidatit të Kamzës zotit Rakip Suli në fushatë elektorale. Është shpërndarë nga Zyra Vendore e Arsimit parauniversitar Korçë, Pustec ...e theksova në krahë të zotit Rakip Sule. Nga gjimnazi, shkolla “Naum Veqil Harxhi” Korçë, është shpërndarë i njëjti postim në krahë të kandidatit të Kamzës, zotit Rakip Sule.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



Z. I. Celibashi: Këto janë të shpërndara nga profilet e...

Përfaqësuesi Komitetit Shqiptar të Helsinkit: Nga profilet e shkollave, nën juridiksionin e ZVA-së Korçë dhe nga vetë ZVA-ja Korçë, Pustec. Të përfundoj të lutem. Gjimnazi “Themistokli Gërmenji” faqja zyrtare, gjithashtu, një veprimtari politike të ministres Kushi. E çmoj të rëndësishme t’i theksoj, nuk janë shumë; Shkolla “Sotir Gurra” faqja zyrtare, ministrja Kushi shfaqet në krahë të kryetares aktuale të bashkisë së Durrësit, zonjës Emirjana Sako, dhe njëkohësisht dhe kandidat e Partisë Socialiste dhe është bërë “share” në profilin zyrtar të shkollës. Shkolla publike “Naim Frashëri”...

Z. I. Celibashi: Ndjesë, në lidhje me rastin e kryetares së bashkisë Durrës. Përmbajtja e atij postimi ka rëndësi mendoj unë, sepse zonja Sako, duke qenë dhe kryetare e bashkisë mund të jetë në funksionin e saj si kryetare bashkie, nëse është në rolin e kandidates, atëherë, patjetër që jemi përpara një problemi.

Përfaqësuesi Komitetit Shqiptar të Helsinkit: Ky është një fenomen kompleks, dhe analizohet qëllimi se pse kjo ka ndodhur.

Z. I Celibashi: Për t’i marrë rast pas rasti. Një rast kur ishte kandidat për kryetar bashkie...

Përfaqësuesi Komitetit Shqiptar të Helsinkit: Po, sepse një veprimtari e ndodhur në qarkun e Durrësit me kryetaren supozojmë, jo kandidaten, kryetaren e bashkisë së Durrësit, cili është qëllimi që shpërndahet nga një shkollë në Korçë. Nuk e lidh asgjë, edhe sikur të jetë ushtrim e detyrave të veta funksionale, mënyra dhe analiza në çdo element të dhënë dhe të ditur të

fenomenit, prodhon të dhëna të besueshme mbi qëllimin e vërtetë të këtij organizimi.

Z. I. Celibashi: Ju kuptoj, tej kësaj çfarë ne shohim nëpërmjet fotografisë, pra shohim një fotografi të ministres me një kryetare bashkie. Ilustrimi i kësaj fotografie, apo ndonjë përmbajtje shoqëruese e kësaj fotografie, na thotë dicka? Apo nuk kemi fare të tilla? E kemi thjesht dhe vetëm në fotografinë.

Përfaqësuesi Komitetit Shqiptar të Helsinkit: Po kemi. E kemi këtë rast, kemi dokumenta... Për shembull, shkolla 9-vjecare “Hamza Vlasi” në Maminas, ka bërë “share” dhe thotë: “Elbasan, derë më derë në lagjen 5 Maji, duke takuar banorët, duke diskutuar problematikat dhe pritshmëritë e tyre, dhe duke marrë gjithnjë e më shumë mbështetje për Partinë Socialiste”. E njëjta gjë ka ndodhur edhe për gjimnazin “Fiqeri Dine” Maqellarë në ZVA, Dibër. Pra ai fenomen, të cilët ne e identifikojmë në ZVA-në Korçë dhe që mendojmë që dhënia hierarkike e këtij urdhëri, për plotësimin e excelit ka pasur një synim shumë më të gjerë dhe është shtrirë në të gjithë vendin. Pra, ajo se çfarë ne e konstatuam në Korçë, në një mënyrë shumë të koordinuar është shtrirë edhe në vende të tjera. Gjimnazi “Fiqeri Dine” Maqellarë, ZVA Dibër, të njëjtin postim me logot e një partie dhe subjektit politik me pjesëmarrjen e kandidatit Gledian Llatja. E njëjta problematikë edhe në një postim tjetër shkolla 9-vjecare “Hamza Vlasi” Maminas. Shkolla 9-vjecare “Hamza Vlasi”, Maminas na del përsëri. Gjithashtu edhe me “share” nga gjimnazi, shkolla publike “Naim Frashëri” në Korçë, për takimin dhe promovimin e ministres me kryetaren e bashkisë së Beratit. Shkolla “Belorta” pranë ZVA-së Korçë bën të njëjtin publikim, shkolla ZVA, shkolla “Belorta” bën publikimin e një takimi elektoral me pjesëmarrjen e zotit Gledian Llatja dhe zotit Damian Gjikhuri. Për të gjitha.....

Z. I. Celibashi: Kam dhe une një pyetje të lutem. Të gjitha këto janë informacione të marra nga profili i shkollave? Jo! Nga profili i shkollave po e po. Po shkollat kanë ripostuar...

Përfaqësuesi Komitetit Shqiptar të Helsinkit: Ministren, faqen personale të ministres.

Z. I. Celibashi: Faqen personale të ministres.

Përfaqësuesi Komitetit Shqiptar të Helsinkit: Po! Theksoj se tek exceli kërkohet shpërndarja e faqes së ministres. Pra dhe shkollat, ne argumentojmë se kanë vepruar në perputhje me këtë komunikim zyrtar. Sepse kolona e fundit nuk thotë faqen e ministrisë, por faqen e ministrave, dhe plus që të dhënat e tjera indikative që kerkohen janë të tilla që ne na bëjnë të dyshojmë se përdorimi i burimeve shtetërore është evidente në këtë rast. Dëshirojmë të theksojmë se vendimi nr. 9, i 2022-shit, është shkelje në këtë rast, në pikën 1.3, germa “ç”, për të mos e theksuar, i cili parashikon edhe mjetet e komunikimit elektronik, si një nga format e përdorimit të burimeve shtetërore, shkelet në pikën 6, pika 3, shkelet gjithashtu neni 91, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Nga të dhënat e vëna në dispozicion ne konstatojmë se ngritja, administrimi dhe përditësimi i të dhënave në databazën excel ka si qëllim promovimin e veprimtarive aktiviteteve të përfaqësuesve të pushtetit Ekzekutiv Qendror dhe subjekteve të përfshira në zgjedhje. Gjithashtu ne mendojmë se jemi përpara rastit të parashikuar nga neni 8, i vendimit nr. 9-të të 2020-s, i cili thekson se: “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në rast se, kur, kryesisht ose me informacion të paraqitur nga palët, konstaton shkelje të detyrimeve të përcaktuara në këtë kre, paralajmëron me shkrim partinë politike, subjektin zgjedhor apo kandidatin në favor të të cilit është kryer veprimtaria e punonjësi, duke kërkuar ndërprerjen e kësaj


**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023**

veprimtarie dhe marrjen e masave për mospërsëritjen e saj në të ardhmen. Paralajmërimi njoftohet publikisht edhe në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Mendojmë se është një fenomen i cili duhet trajtuar në fenomen makro. Ne morëm indicie, fillimisht nga rasti i Korçës, por me një kontroll të shpejtë të situatës që kemi bërë kemi rezultuar në këto prova, të cilat ia vendosim në dispozicion administratës suaj dhe kërkojmë nga ju të merrni masa për ndërprerjen e kësaj veprimtarie, po ashtu mendoj se Ministrisë së Arsimit duhet t’i tërhiqet vëmendja në mënyrë zyrtare për mospërsëritjen e një praktike të tillë. I njëjti komunikim zyrtar duhet bërë për ZVA-të dhe për shkollat, sepse shohim që vetëm komunikime lidhur me procesin akademik mësimor nuk kanë bërë këtë rast, por kanë bërë “share” të situatave zgjedhore dhe mendojmë që është në çmimin e Komisionerit, në rast se sheh mundësinë që në këtë rast mund të trajtohet më masë administrative dhe sanksione të tjera konform parashikimeve ligjore. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po

Përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: Atëherë përshëndetje, unë jam përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ne kemi paraqitur pretendimet tona më dt. 5 prill, përsa i përket ankesës së Komitetit të Helsinkit që lidhet me një email të derguar nga ZAV Korçë kundrejt drejtorive arsimore. Ndërkohë të dhënat që paraqiti sot Komiteti i Helsinkit lidhet edhe me zyra të tjera arsimore që nuk janë paraqitur në denoncimin. Dhe ne kemi marrë informacion nga ZAV Korçë, përsa i përket denoncimit që është paraqitur nga Komiteti i Helsinkit. Në lidhje me tabelen në excel ku pretendohet që kërkohet shpërndarja e postimeve të ministres, te tabela theksohet: “Shpërndahen postimet e ministres për arsimin parauniversitar”, d.m.th. edhe në këto momente theksohen edhe përmbajta që do të kenë këto postime. Përsa i përket pjesës së

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Ministrisë së Arsimit, nuk ka ndonjë denoncim përkundrejt Ministrisë së Arsimit. Veprimtaria e kryer nga ZAV Korçë ka thjesht si qëllim të identifikojë këto faqe, sepse provat që pretendohen që paraqiten nga Komiteti i Helsinkit, janë marrë nga faqe të ndryshme në facebook dhe shkollave të ndryshme që mund të mos jenë faqe zyrtare të përdora nga institucionet.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesi i koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. F. Nuri: Faleminderit i nderuar zoti Komisioner. Marr shkas nga denoncimi dhe nga rasti i sjellë këtu nga Komiteti i Helsinkit për t'i inkurajuar që të vazhdojnë në këtë linjë dhe për t'i mbeshtetur. Thjesht, desha të sjell në vëmendjen tuaj, por edhe të përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit këtu, apo të organizatave të tjera, që ne si opozite kemi bërë denoncim në SPAK, për platformën dhe programin e Partisë Socialiste, Aktivisti që ka identik të njëjtin procedim dhe të njëjtë metodë pune si tabela excel aty, që u paraqit, ku i detyrojnë të gjithë punonjësit që kanë shkarkuar atë aplikacion të administratës që të bëjnë "like dhe share". Dhe përfitoj nga rasti të them që aty kemi dencuar Kryeministrin Edi Rama në SPAK dhe anëtarë të kabinetit qeveritarë. Duke qënë së rasti në fjalë është një rast pothuajse identik, ftojme Komitetin e Helsinkit që këtë rast ta referoje jo vetem ne KQZ, por edhe ne SPAK për shkelje të nenit 329, 328 /a të Kodit Penal, të përdorimit të burimeve shtetërore dhe administratës për qëllime zgjedhore, nenit 248 për shpërdorimin e detyrës nqs nuk skualifikohet nga vepra të tjera ose 328 të Kodit Penal. Pra, inkurajojme që t'i drejtohen SPAK-ut me të gjitha këto prova për ministren dhe për të gjithë ministrat e tjerë që kanë bërë shkelje të tilla të kësaj natyre që në një mënyrë ose një tjetër kanë detyruar administratën që mos të merren me punët e sektorit të vet perkatës, por të merren me fushatë zgjedhore. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, keni ndonjë diskutim tjetër? Jo nuk kemi! Mirë, atëhere unë vleresoj që... Po paraprakisht dua ta sjell në vëmendje të të gjithëve që ka një dallim shumë të madh ndërmjet natyrës dhe përmbajtjes së denoncimeve që paraqiten në kuadër të zhvillimit të këtyre zgjedhjeve, të veprimtarive të institucioneve publike me eksperiencat e shkuara. Flitet pergjithësisht për mënyrën se si institucionet publike e qasin veprimtarinë e tyre, apo edhe perfaqësuesit e institucioneve publike qasin veprimtarinë e tyre në rrjetet sociale dhe kjo do të thotë që ka një dallim të madh krahasuar me eksperiencat e shkuara. Nësë eksperiencat e shkuara denoncimi ishte: përdori makinë, mori administratën me vete, i vendosi ata që të bënin këtë apo atë. Ka në vlerësimin tim, goxha ndryshim dhe kjo meriton të theksohet, si meritë më së pari edhe e veprimit të organizatave të shoqërisë civile, por edhe të institucionit të KQZ-së për ta mbikqyrur këtë proces, ndoshta edhe të ndërgjegjesimit të institucioneve publike. Por, natyrisht kjo nuk do të thotë që meqë natyra e shkeljeve është e tillë dhe do të duhet të kemi gjithë mirëkuptimin, vençanërisht në rastin konkret unë mendoj që çfarë ka sjellë në vëmendje Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ashtu si edhe pak më përpara KRIIK, do të duhet të adresohen. Jemi para një rasti, nuk jam dakord me përfaqësuesin e koalicionit Bashkë Fitojmë po kjo është një çështje që, normal gjithsecili prej nesh ka pikëpamje e veta, e vlerësimet e veta. Jemi para një shkeljeje administrative të Kodit Zgjedhor dhe mendoj që i kemi dhënë të gjitha paralajmërimet në lidhje me këtë çështje dhe pse jemi të ndërgjegjshëm që ka objektivisht kuptime të ndryshme nga të gjithë aktorët në lidhje me çështjen e pasqyrimin të fushatës elektorale në rrjetet sociale, përkatësia e rrjeteve sociale etj... Por, ne publikisht e kemi bërë të qartë se kush është dallimi ndërmjet një profili zyrtar dhe personal. Dhe në rastin konkret, pa i hyrë fare përmbajtjes, pasi në disa raste përmbajtja ishte e qartë që ishte e karakterit thjesht dhe vetëm institucional, por në disa raste ishin dhe aktivitete me karakter politik dhe thirrje me karakter politik dhe ndoshta do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

duhet kishte pasur një aktivitet me vemendje të shtuar nga ripostuesit e këtyre artikujve, shkolla apo institucione të tjera arsimore. Ndaj, për të mos lënë mundësi për interpretime dhe dy apo tri kuptueshmëri, apo më shumë kuptueshmëri, ne do të urdhërojmë që të ndalohen ripostimi i aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilet e rastit konkret të ministres konkrete, por edhe të ministrave të tjerë për sa kohë ata, këto profile i konsiderojnë profilet e tyre personal. Pasi do të duhet ta ndajmë e kanë profil personal apo e kanë profilin e ministrit. Aty nuk duhet të ketë asnjë postim të karakteri elektoral. Nëse është profil i tyre personal ata mund të bëjnë çfarë të duan dhe mesa kemi kuptuar këto janë profilet e tyre personale dhe e njëta llogari u ngelet atyre ose ata perdorin pasi lënë detyrën. E kanë pasur para se ta merrnin kete detyrë, e kanë gjatë ushtrimit të detyrës dhe do të vazhdojnë ta mbajnë besoj pasi lënë detyrën dhe duke qënë të tillë profile personale nuk do të duhet që postimet që ata bëjnë në profilet e tyre që ata janë të lirë për t'i bërë ato, të ripostohen nga institucionet publike. Dakord? Mirë vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimit të deputetes Albana Vokshi ndaj drejtorisë... jo ishte kjo, e njëjta gjë. Kemi denoncimin e Partisë Socialiste për vendosjen e materialit propagandistik në bashkinë e Kavajës. Besoj përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë fitojmë” është njohur...

Z. F. Nuri: Po, i nderuar! Jam njohur nga rendi i ditës për këtë pikë të çështjes dhe ne kërkojmë që përpara se të shqyrtohet kjo çështje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kërkojmë që e para të verifikohet në terren nëse është shkelur distanca apo jo, duhet parë... dhe përpara kësaj dëshirojmë që t’ju kujtojmë edhe një herë që merrni masa për shkelje disi më të rënda që kanë ndodhur, sic është mbushja e gjithë rrugëve, autostradave të Shqipërisë, rrugëve të qyteteve dhe qëndrave të qyteteve me postera të Partisë Socialiste dhe Kryeministrit Rama që janë krejtësisht në kundërshtim me ligjin. Mendoj që ato janë një shkelje mjaft

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.04.2023*

flagrante më e rëndë se sa kjo çështje të themi dytësore që mund të shqyrtohet ndoshta në ditët në vijim. Ky ishte qëndrimi ynë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po pa diskutim do ta verifikojmë dhe do të vendosim në ditët në vijim në lidhje me këtë, por natyra e denoncimit është përmbajtja, lidhet me faktin që është vendosur në një institucion publik. Gjithsesi do të bëjme verifikimet dhe ndërkohë jemi në proces sikurse ju e dini jemi në shqyrtim të denoncimeve që ka bërë koalicioni Bashkë Fitojmë në seancën e djeshme nëse nuk gabojmë, të pardjeshme, bëmë shqyrtimet e denoncimeve të koalicionit Bashkë Fitojmë në lidhje me posterat e Partisë Socialiste të vendosura në bashkinë e Tiranës, në disa bashki të tjera dhe në disa rrugë nacionale dhe jemi në proces të vlerësimit. Mirë, faleminderit! Çështje të tjera në rend dite? Nuk kemi! Mirë, seanca mbyllet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

